



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 432/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Laziq dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bajrush Ymeri nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, dega në Novobërdë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt.26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bajrush Ymeri nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Novobërdë.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimin për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV) 3415E/01D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutsisë së votimit të VV si në pikën -II- të këtij diapozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik LDK dega në Novobërdë, me të cilën pretendohet se në vendvotimin nr.3415E/01R në Kishnicë të komunës së Graçanicës, Bajrush Ymeri me nr: 73 nga radhët e LDK-së, pretendon se ka (marre 36 vota), sipas Formularit të Rezultateve të Kandidatëve FRK, ndërsa kryesuesi i vendvotimit votat e tij ja ka bartur kandidatit me numër 72.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar formularin e vëzhguesit Bilall Makolli .

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme* “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

#### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Bajrush Ymeri nga subjekti politik LDK, në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se i janë bartur votat tek kandidati tjetër në vendvotimin VV nr: 3415E/01R.

Nga ekipi i PZAP-it, është konstatuar se kutia e votimit me nr. 3415E/01D për Komunën e Graçanicës ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 005751, 005712, 005752 dhe 005711 ndërsa shiriti i mesëm nr. 005720 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit mbante nr.005705.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it, ka konstatuar se kandidati me nr.73 nga radhët e subjektit politik LDK, se në vendvotimin me nr: 3415E/01R ka pasur (36 vota) nuk qëndron sepse VV nr: 3415E/01R , ngase kjo QV nuk ekziston si numër më çka është vërtetuar nga master lista e KQZ-së ku nuk ka qendër të votimit sipas pretendimeve ankimore.

Mirëpo ekipi i PZAP-it, ka konstatuar po ashtu nga master lista se është vetëm një vendvotim nr: 3415/01D që ekziston në vendin konkret (komuna e Graçanicës-fshati Kishnicë), andaj e ka vlerësuar si një gabim teknik nga pala ankuese dhe e ka hapur kutinë e votimit me nr:3415/01D e cila kuti e votimit ka të bëjë me pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë.

Konstatohet nga Formulari i Rezultateve për Kandidatë FRK-ja, origjinale në Qendrën e Votimit dhe Rezultateve QNR, se kandidati me nr 73 e posedon 1 votë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, komuna e Graçanicës, ndërsa pas hapjes së kutisë të votimit dhe numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë rezultojnë se i njëjti i (posedon 36 vota) në kutinë e votimit nr: 3415E/01D siç edhe ka pretenduar në ankesën e tij Anr.432/2014. Pas përfundimit të hetimit thesi brenda kutisë ishte mbyllur me shiritat e sigurisë me nr: 0010321, 0010322, 0010323 dhe 0010324, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 dhe 117.4 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i, mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 432/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*